

mëri do të thuash në vete La ilahe il-lall-llah, jo o vëlla... Nëse mbetesh me devijimin dhe refuzimin tënd në çast të vdekjes nuk mund që ta thuash këtë fjalë, por do të shpresosh që të kthehesh në dunja: **"E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja ai thotë: O Zot! im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompenzoj atë që e leshova! Kurse si (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai."** (El-Mu'minin: 99-100). Përse e thotë këtë fjalë pas përfundimit të jetës. Vëllai im, a e di se kur do të vdesësh e ku do të vdesësh?! Jo, Vall-llahi! Përse e vonon pendimin atëherë? Lexo këtë ngjarje ndoshta do të këshillohesh. Më ka treguar një njeri këtë ngjarje, për të cilin shpresoj se është nga të sinqertit, një i ri i cili i ndodhi një rast tragjik dhe shpejtoi një polic nga ai te vetura e tij që ta kërkon atë dhe e pa të riun se po i afrohet vdekja, dëgjoi nga ai duke gargaruar, ndërsa ky i tha atij: Thuaj: La ilahe il-lall-llah, e i riu e ngriti gishtin tregues në qiell dhe tha: La ilahe il-lall-llah, pastaj u nda nga kjo botë, pasi që është larë i vdekuri dhe i është falur namazi, ky polic shkoi te shtëpia e familjes së të riut, që të lajmërojë se biri i tyre ka thënë shehadetin para se të vdes, e iu afrova atyre dhe u tha: **"Ju përgëzoj se biri i tuaj ka thënë shehadetin para se të vdes, familja e të riut, i thanë policit: ne të përgëzojmë ty se biri ynë është penduar dy javë para ngjarjes."**

"Pendimi i pranueshëm te All-llahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen në mos dije e pastaj shpejt pendohen, të tillëve All-llahu ua pranon pendimin, se All-llahu është më i Dijshti më i Urti. Nuk është pendimi (i pranueshëm) i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqija dhe vetëm atëherë kur t'i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: Unë tash u pendova!" (En-Nisa: 17-18) Paramendo pas tërësaj, ndërsa je duke hyrë në varreza i mbajtur mbi krahët. Ah, sikur ta dije çka ndodhë me xhenazen tënde, a do të thuash shpejtoni, shpejtoni, apo do të thuash: o mjer për mua ku do të shkoni me atë, pastaj do të zbrasin në varrin tënd me të dashurit tu, me të afërmit. Të vendosin në shtresën e tokës, ndërpriten arritja e dritës mbi ty... Thotë njëri prej tyre: kërkonti falje për vëllain tuaj, sepse ai tash pyetet. Pastaj shkojnë e të lënë ty, po, të lënë ty të vetëm në atë errësirë të tmershme, dhe pastaj të kthehet shpirti yt në trup, të vijmë dy melekë, njëri i zi (Munker) dhe tjetri i kaltër (Nekir), të pyesin: Kush është Zoti yt? Cila është feja jote? Kush është peygamberi yt? Me çka dëshiron të përgjigjesh? Nëse ke qenë gjatë jetës tënde i penduar, i sinqertë, besimtar, All-llahu do të përforcojë në atë gjendje: **"All-llahu forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote edhe në botën tjetër"** (Ibrahim: 27). Do të thuash: Zoti im është All-llahu, feja ime është Islami dhe peygamberi im është Muhamedi (s.a.v.s.), thërrer një thirrës nga qielli dhe thotë: të vërtetën e tha robi im, shtroni atij shtroje prej Xhenetit dhe visheni atë me tesha prej Xhenetit, hapjani ati një derë për në Xhenet, e të vjen ty një erë e këndshme dhe të zgjerohet varri sa largësia e të pamurit, paraqitet një njeri me fytyrë të bukur, tesha të bukura dhe erë të mirë, i cili thotë: gëzohu për kënaqësinë e All-llahut dhe Xhenetit me begati të përleshme, kjo është dita që të premtotohej, i thotë ky atij. Edhe ti, u gëzofsh gjithmonë, kush je ti? Fytyra jote është e atij që vjen me hajr, i thotë: unë jam puna jote e mirë, betohem në All-llahun, unë nuk të njohë ndryshe përveçse të shpejtë në bindjen ndaj All-llahut dhe të ngadalshëm në mosbindjen ndaj Tij, All-llahu të shpërbleftë me të mira. Pastaj i hapet një derë nga Xheneti dhe një nga Xhehennemi dhe i thuhet ky do të ishte vendi yt (në Xhehennem) po të mos e respektoje All-llahun, All-llahu të nderoi me këtë (vend të Xhenetit) e kur ai sheh se çka ka në Xhenet thotë: O Zot! im, shpejto, shpejtoe ndodhinë e Kijametit! Ah, sa lumturi për ty, o sa gëzim për ty, ky gëzim, o sa shpëtim i mirë për ty. Nëse është robi - All-llahu na mbroftë, i cili e ka lënë fenë e tij pas shpine, lënësi i namazit, i cili tallet me robërit e devotshëm, që bënë vepra të këqija, dhe vdes në këtë gjendje, a e din se me çka do t'i përgjigjet melekëve kur do të pyetet? Do të thotë: ah, ah, nuk e di! Kemi dëgjuar disa duke thënë një gjë të tillë, dhe thojnë: thërrer një thirrës nga qielli: gënjeve, shtrojani atij një shtrojë nga zjarri dhe hapjani atij një derë për në zjarr, nga

nxehtësia dhe flaka i ngushtohet varri derisa edhe i mbështillen edhe pjesët e trupit të tij, atëherë i paraqitet një njeri me fytyrë të keqe me rroba të ndyta dhe erë të keqe e i thotë gëzohu për atë që të shqetëson. Kjo është dita jote që të premtotohej. I thotë ai: kush je ti? Zoti të gëzoftë me sherr! I thotë: unë jam puna jote e keqe, betohem në Zotin se ti çdoherë ishe i ngadalshëm në respektin ndaj All-llahut dhe i ngutshëm në mosbindjen ndaj Tij, All-llahu të shpërbleftë me sherr. Pastaj All-llahu ia dërgon atij një të verbër dhe shurdhëmec i cili mban në dorën e tij një shufër, sikur me të t'i bijë malit do ta bënte pluhur, me të njëjtin i bie atij dhe e bën pluhur, pastaj All-llahu e kthen ashtu siç është më parë dhe i bjen atij edhe njëherë me ç'rast lëshon një britmë të cilën e dëgjon çdo gjë përveç dy grupeve (njerëzit dhe xhinnet), pastaj i hapet atij një derë për në zjarr dhe i shtrohet atij shtrojë nga zjarri, e ai thotë: o Zot, mos e bën Kijametin.

Një ditë doli Ali Ibën Talibi r.a. me disa shokë të tij në varreza, pasi që i përshëndeti banorët e tij tha: **"O ju banorë të varrezave, na lajmëroni neve apo ne t'ju tregojmë, sa na përket neve, pasuria është shpërndarë, gratë janë martuar dhe shtëpitë të banuara nga tjetër kush"**, pastaj heshti pak u drejtua shokëve të vet duke thënë: **"Po qe se u jepet rasti të flasin do të thoshin: 'Edhe përgatituni me furnizim (për rrugë) e furnizimi më i mirë është devotshmëria ...'** (El-Bekare:197)"

O ti, i cili do të jeshë nesër prej banorëve të varrit, kush të mashtroi ty për dunjane? Ku është ajo shtëpi e gjerë? Ku është ajo veshje e bukur? Ku është ajo era e mirë e ytja? Ku është ajo fytyra jote e bukur? Ku është lëkura jote e hollë? Ku është trupi yt i mirë? E si do të jetë me ty pas tre netëve kur do të varrosin, të kaplojnë brengat dhe përhapen rreth teje krimbat, kur do të shkyhet qefini, largohen ngjyrat, e kur të hahet mishi, e kur të bëhen eshtrat pluhur, kur do të copëtohet trupi. U ndal Hasan Basriu pranë një varri dhe shikoi në të një kohë të shkurtër, pastaj u drejtua njërit prej njerëzve duke i thënë: **"Çka do të vepronte nëse dilte prej varrit? Tha: Do të pendohet dhe do ta përmend All-llahun. Atëherë, Hasan Basriu tha nëse ai kishte për ta vepruar këtë atëherë bëhu ti."** Vëllai im gjeje rrugën e shpëtimit, përgatitu për veten tënde para vdekjes. Përvjelu me seriozitet pasi ajo (vdekja) vjen e ti mos u mashtro me vegimin e kësaj jete. Shiko në veten tënde çka ke përgatitur, ashtu që të jetë varri yt një kopsht prej kopshteve të Xhenetit. Vëllai im, si do të jetë gjendja jote: **"Në ditën ku njerëzit ngriten (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve."** (El-Mutaffifin:6)

Do të dalim unë dhe ti duke u paraqitur para All-llahut (s.v.t.), a e ke menduar o rob i dobët, qëndrimin tonë para All-llahut: Në këtë qëndrim të frikshëm, trishtues në të cilin: **"... secila gjdhënëse braktis atë që ka për gjini dhe secila shtatëzëne e hedh para kohe barrën e vet ndërsa njerëzit duken të dehur, por ata nuk janë të dehur, por dënimi i All-llahut është i ashpër."** (El-Haxh: 2)

Me se do t'i përgjigjemi Zotit tonë kur do të pyetemi për çdo gjë të vogël apo të madhe? **"...ç është puna e këtij Libri që nuk ka lënë as (mekat) të vogël e as të madh pa e përfshirë? dhe atë që vepruan e gjejnë të gatshme, prezente, e Zoti yt nuk i bën të padrejtë askujt."** (El-Kehf: 49)

Si do të jetë me ty kur do të dëshmojnë sytë, duart, këmbët, veshët, organi, gjuha në atë që punove për këtë botë të kalushme? **"Sot ne ua mbyllim gojë të tyre, Neve na flasin duart e tyre kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan."** (Ja Sin: 65);

"Ju nuk fshiheshit (kur bënit mëkate) se do të dëshmojnë kundër jush të degjuarit tuaj të parit tuaj dhe lëkurat tuaja bile ju mendoat se All-llahu nuk di për shumë gjëra që ju i bënit." (Fussilet: 22) Jeta shkurtrohet e mëkateit zmadhohen, kurse pasojat dhe mëkateit po kthehen. A mundet të mohohet një mëkat, kur gjymtyrët e personit kundër tij dëshmojnë?

Enes Ibën Maliku s.a.v.s. thotë: "Ishim te Resulull-llahu s.a.v.s., ndërsa ai filloi të qeshë dhe tha: **A e dini se përse qesha?** Tha (Enesi): Thamë: All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. Tha (Muhammedi s.a.v.s.): **Me të folu-**

rit e robit me Zotin e Tij, e ai thotë: O Zoti im, a nuk më ke shpëtuar nga zulumi (padrejtësia)? All-llahu thotë: Po si jo! (Robi) Thotë: Unë nuk ja lejoj vetes përveç një dëshmitar. All-llahu thotë: Mjafton për dëshmitar sot vetja jote dhe Kiramun Katibin, pastaj atij i mbyllet goja e i thuhet gjymtyrëve të tij flitni, e ata do të flasin sipas veprave të tyre, pastaj veçohet mes tij dhe të shprehurit të tij, e i thuhet: larg (gjymtyrëve) për ju, të mallkuar qofshit, unë për ju kam bërë luftë". Parafytyro veten tënde kur ishe fëmijë i vogël kur nuk pate mëkate e as mëkate, mendo si të ruajt All-llahu nga çdo e keqe.

E kur foshnja është varur për nënën e saj, frikohet prej ndëshkimit me zemër të trishtuar. Dhe duke qenë pa mëkat frikohet nga trishtimi i tij, e si frikohet ai që vazhdon tërë jetën në mëkate.

A jemi përgatitur të japim përgjigje për pyetjen që do të na parashtrohet në Ditën e Gjykimit, e të japim një përgjigje të saktë. O vëlla i dashur e i bekuar, përkujto, të përkujtoftë All-llahu me shehadet në çastin e vdekjes, në atë çast të vështirë. Pastaj, mendo o vëlla, si do të jetë gjendja e krijesave që bëjnë krahasimin me fatkeqësitë e Kijametit dhe trishtimet e tij. Atëherë kriminelët do të binden se do të jenë të shkatërruar: **"Kriminelët e shohin zjarrin dhe binden se do të hudhen në të dhe se nuk gjejnë shtegdalje prej tij."** (El-Kehf: 53)

Del një thirrës prej zëbanive duke thënë: "Ku është filani i biri filanit i cili i linte punët pas dore duke shpresuar jetë të gjatë, i cili e ka kaluar jetën në humbje me vepra të këqija, fillojnë e nxitojnë kah ai me shufra të hekurit dhe e presin me kanosje më të rrepta, e shpiejnë në një dënim të vështirë dhe e përmbysin me fytyrë në fund të Xhehennemit, i thuhet atij: **"(I thuhet) Shijojë! Se ti je ai i fortë, i autoritetshmi."** (Ed-Duhan:49). E vendosin në një vend ku dy anë të ka të ngushtë, rrugët e tij që janë të errëta qe e shpiejnë në shkatërim, e thërrasin atë me mallkime e qortime dhe përgjegjësi të madhe. **"E kur të hudhen duart lidhur në një vend të ngushtë në të, aty do të kërkojnë shkatërrimin (vetëzhdukjen) tash mos kërkonti vetëm njëherë shkatërrimin, po atë kërkonie shumë herë."** (El-Furkan: 13-14)

Dëshirat apo shpresat e tyre do të jenë shkatërim dhe për banorët e Xhehennemit nuk ka rrugëdalje, u shtrëngohen këmbët dhe të, u nxihen fytyrat prej errësirës së mëkateve, thërrasin dhe gërhasin nëpër anët e saj dhe përqark saj: O Malik, e kemi merituar premtimin, na ka rënduar hekuri, o Malik, na janë djegur lëkurat, o Malik, zhdukja për ne është më mirë se të ekzistojmë, o Malik, na nxjerr prej këtu se nuk do të kthehemi: **"Dhe ata thërrasin: O Malik, le të na i marrë shpirtin Zoti yt! Ai thotë: Ju do të jeni aty përgjithmonë."** (Ez-Zuhruf:77)

"Ata thonë: O Zoti ynë ne na patën mundur të këqijat (u dhamë pas epsheve të dunjasë) dhe si të tillë ishim popull i humbur! Zoti ynë na nxjerr prej tij, e nëse gabojmë përsëri, atëherë, vërtetë, jemi mizorë! Ai thotë: Heshtni aty e mos më folni." (El-Mu'minin: 106-108)

Atëherë, në ato çaste do të humbin shpresa në atë që kanë lënë mangu respektimin ndaj All-llahut dhe do të kërkojnë ndjesë, zjarri do të jetë rreth tyre... **"Se ata do të kenë shtresa të zjarrit edhe sipër edhe përfundit."** (Ez-Zumer: 16)

Do të jenë të fundosur në zjarr, ushqimi dhe pija e tyre do të jetë zjarri, rrobet e tyre do të jenë nga zjarri **"E atyre që nuk besuan u qepën rroba prej zjarri u hudhet ujë i valë mbi kokat e tyre, që me atë u shkrihet krejt ç'ka në barqet e tyre edhe lëkurat."** (El-Haxh:19-20)

Dëshirojnë të vdesin, por nuk ka vdekje për ta: **"Atij i vjen vdekja nga të gjitha anët (sipas shenjave shkatërruese), po ai nuk vdes (e të shpëtoj prej vuajtjeve), e të pret dënim shumë i rëndë."** (Ibrahim:17)

Ah, sikur ta dije si do të jetë me ty kur do t'i shikosh ato fytyra të atyre që do të jenë të nxira, do t'u verbërohen sytë, do t'u mbyllen gojë, ah, sikur ta dije si do të jetë kur t'i shihje ato duke i kapluar flaka e zjarrit në brendësinë e pjesëve të tyre, gjarpëritë e Xhehennemit dhe akrepat të varur nëpër gjymtyrët e tyre, si do të jetë kur t'i shihje ato mes flakës të zjarrit me rroba të

katranit: **"Ndërkaq, kujt i jepen librat e veta nga e majta e tij ai thotë: O i mjeri unë, të mos më jepen fare libri im. Dhe të mos dijsa fare se çka është llogaria ime. Ah, sikur të kishte qenë ajo (vdekja e parë) mbarim i amshueshëm për mua. Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë imja. U thuhet zëbanive: Kapeni atë, vënja prangat! Pastaj atë shtininë në Xhennem... Mandej, lidhne atë me një zinxhirë të gjatë shtatëdhjetë kutë. Pse ai ka qenë që nuk besoi All-llahun e madhëruar. Ai nuk nxiste për t'i ushqyer të varfërit. Ai sot nuk ka këtu ndonjë mik. As ushqim tjetër përveç të të shplarave. Që atë nuk e ka kush, pos mëkatarëve."** (El-Hakka: 25-37)

All-llahu na mëshiroftë mua dhe ty, se ky vend me pikëllimet dhe vështirësitë e saj, e përballë saj qëndron një vend tjetër, pra eja me mua të mendojmë në disa kënaqësi dhe mirësi të saj, po, të mendojmë për banorët e Xhennetit pasi që e kalojnë rrugën e Siratit që është e ngritur përmbi Xhennem, ndërsa duke pritur te dera e Xhennetit vjen Muhammedi (s.a.v.s.) e trokit derën e tij, thotë Ridvani, roja e Xhennetit: Kush është? Thotë: Muhammedi (s.a.v.s.): **Atëherë, thotë rojtari: Jam urdhëruar vetëm ty të ta hapi derën, hyn Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe me atë hyjnë banorët e Xhennetit, paramendoe veten tënde o vëllai i im, nëse ke qenë i penduar në dunja, duke qarë për mëkatet, duke iu frikësuar Zotit tënd, mendo veten tënde kur do të hysh me ata që do të hyjnë në Xhennet, me mëshirën e All-llahut (s.v.t.), do të hysh në Xhennet në të cilin ka gjëra që syri nuk i ka parë, që veshi s'ka dëgjuar, dhe as që mendja i ka shkuar ndonjëherë. Mendo kur do të kënaqesh me hyritë në të, të jetosh në pallate të Xhennetit, të hash nga frytet e tij, të pish nga lumenjt e tij, po mendo veten kur do ta shikosh fytyrën e Mëshiruesit në Ditën e Gjykimit. Ibën Kajjimin [All-llahu e mëshiroftë], thotë: **"Nëse pyet për nusët e xhenneteve, ato janë vasha të reja të një moshe në gjymtyrat e të cilave rrjedh ujë i rinisë. Kur e takon të dashurin e saj, atëherë, thuaj ç'të duash për takimin e dy dritave, e nëse i slet atëherë ç'do të thuash për bisedën e të dashurve, e nëse e përqafton, atëherë, ç'do të thuash për përqaftimin e dy degëve, lidhja e saj është më e këndshme për atë se sa dëshirat tjera. Sa më shumë të zgjatë kjo, u shtohet bukuria dhe estetika, sa më tepër vazhdon kjo, shtohet lidhshmëria dhe dashuria, mirëpo janë të pastërta nga shtatëzania, hajdi dhe nifasi, të pastërta nga çdo e metë dhe ndytësirë njerëzore, mbesin të reja përgjithmonë dhe rrobet e tyre nuk u vjetërohen. Këto nuk i ka prekur përpara as njeri as xhin, sa herë që shikon kah ajo, i mbushet zemra me lumturi, sa herë kur të slet ajo, ia mbush veshin me margaritarë të thurrur, e kur të paraqitet e mbush pallatin dhe dhomat me nur (dritë), nëse pyet për sjelljet dhe kënaqësitë atje, ato (hyritë), janë të këndshme dhe të dashura, e kur të këndon, ah, sa kënaqësi për shikim dhe dëgjim që është, e kur të shoqëron dhe të kënaqë, sa shoqërim dhe kënaqësi e madhe, e nëse e puthë nuk ka gjë më të këndshme se kjo. Nëse pyet për lumenjt e Xhennetit, aty janë lumenjt prej ujit të kthjellët, lumenj prej qumështit të pandryshuar, lumenj prej verës së këndshme për pirësit, lumenj prej mjaltit të kulluar. Nëse pyet për ushqimin e tyre, janë fryte nga të cilët zgjedhin dhe mish shpeze që ua ka ëndja. Nëse pyet për pijet e tyre ato janë: tesnim (ujë më i mirë), zenzhebil (bimë aromatike) dhe kafur (aromë). Nëse pyet për enët, ato janë nga ari dhe argjendi, nëse pyet për dheun e Xhennetit, ai është misk zaferan. Nëse pyet për kulmin ai është Arshi i Mëshiruesit. Nëse pyet për ndërtesat në të, një tullë është prej argjendi e tjetra prej ari, e nëse pyet për gjerësinë e tij, banori i tij me gradën më të ulët ec në sundimin e vet në Xhennet nëpër pallate dhe kopshte, udhëtimi i cili zgjat 1000 vjet. Nëse pyet për fytyrat dhe bukuritë e banorëve të tij, ato kanë pamjen e hënës, nëse pyet për shërbëtorët në Xhennet, janë fëmijë të amshueshëm si margaritarë të ruajtur. Kjo pra, edhe nëse pyet për ditën në të cilën ka (tepricë për të mirat) dhe takim me të Lartësuarin dhe Falënderuesin, atëherë dëgjo në ditën kur të thëret thirësi: "O banorët e Xhennetit, për ju ka premtim që do ta përmbush (realizon), ata thonë: Çështë ajo? A nuk na ke zbardhur fytyrat dhe na ke rënduar peshojat tona me punë të mira, na ke bërë banorë të Xhennetit dhe na ke larguar nga zjarri. Duke****

qëndruar kështu, u paraqitet një urë që ua ndriçon Xhennetin, pastaj i ngrisin kokat para Krijuesit (All-llahut), të Shenjtë janë emrat e Tij, del para tyre dhe thotë: 'O ju banorë të Xhennetit, paqja qoftë mbi ju, e ata ia kthejnë me përshëndetje dhe fjalë të urta: Allahumme entes selam ve minke selam tebarekte ja dhel xhelali vel ikram! O All-llahu im, ti je paqe, dhe prej teje është paqja e madhëruar, je Ti o Zoti ynë Bujar dhe i Madhëruar!' Pastaj thotë: 'Ku janë robërit e Mi të cilët më adhuronin pa më parë, përpara kjo është Dita e tepricës, ata mblidhen në një fjalë, në jemi të kënaqur, kënaqu edhe ti prej neve', pastaj thotë: 'O ju banorë të Xhennetit, po mos të kisha qenë i kënaqur nga ju, nuk do t'ju kisha strehuar në Xhennetin Tim, kjo është Dita e tepricës kërkoni prej meje'. Atëherë, bashkohen në një fjalë: 'Na trego fytyrën tënde, që të shikojmë', pastaj zbulon Krijuesi (All-llahu) mbulesën dhe u paraqitet atyre, drita e tij i kaplon të gjithë, mirëpo All-llahu (s.v.t.) ka gjykuar që mos të dëgjë në atë tubim askë, saqë nuk mbetet askush në atë tubim pa iu paraqitur All-llahut me një paraqitje. Sa kënaqësi për dëgjim në atë tubim dhe sa kënaqësi për sytë e të devotshmëve duke shikuar në fytyrën e Zotit bujar në Xhennet". **"Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara), Që Zotin e tyre e shikojnë."** (El-Kijame: 22-23)

Shtëpia e paqes. Shtëpia e Strehimit. Shtëpia e grupit besnik që i janë përmbajtur Kur'anit. **"Kujt ti jepet libri i vet nga ana e djathtë e tij, ai do të thotë: O ju, që lexoni librin tim!, Unë kam qenë i bindur se do të jap llogarinë time. Dhe ai atëherë është një jetë e të kënaqshme. Në një Xhennet të lartë. Pemët e tij i ka krejt afër. (E thuhet) Hani e pini shijshëm, ngase në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë."** (El-Hakka:19-24) Pas gjithë kësaj, a nuk janë këta çaste të cilët nxisin që të qajnë dhe lotojnë sytë tanë, a nuk është ky udhëzim që kërkon nga ne që të pendohemi e të kthehemi tek All-llahu. Vëllezër, nxitoni! Shfrytëzoni frymëmarrjet e juaja të rëndësishme sa keni mundësi. Përkujto të gjitha veprimet tuaja që ju bëjnë e t'ju afrojnë në Xhennet apo në zjarr. Në fund të këtij fragmenti po ju përkujtoj për çdo person i cili është fundosur në dëfrime dhe epshe, që ka harruar Zotin e qiejve dhe të tokës, për çdo të penduar i kthyer sinqerisht, që kërkon falje nga All-llahu ju themi që të dyve, sikur atij që i ka thënë Muhammedi (s.a.v.s.): **"Në Ditën e Gjykimit e sjellin njeriun që është kënaqur në këtë dunja e që është prej banorëve të zjarrit, e zhytin në zjarr një çast, pastaj i thuhet: O biri Ademiti a ke parë ndonjë kënaqësi? A ke përjetuar ndonjë kënaqësi? Ai thotë: Jo, vall-llahi o Zot, e sjellin njeriun që ka jetuar në dunja me përjetime dhe vështirësi, por është nga banorët e Xhennetit, e fusin në Xhennet një çast, pastaj i thuhet: O biri Ademiti a ke parë ndonjë vështirësi? A ke përjetuar ndonjë vështirësi? Thotë: Jo, il-llahi, nuk kam përjetuar as që kam pas vështirësi."**

On-line versionin e këtij teksti mund ta gjeni në:
<http://www.evertet.a.cbjo.net/>

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7/18
Tel.++389 (0)2 223-654
1000, Shkup



A ka kush q^o i p^orvjel^o krah^o t^o?

Është thënë Hasan Basriut: **"O Ebu Said, çka të bëjmë ne? I shoqërojmë disa njerëz të cilët na bëjnë që të frikohemi sa që zemrat tona na fluturojnë"**. Tha: **"Vall-llahi, nëse shoqërohesh me ata njerëz që të frikojnë derisa ta arrish sigurimin, është më mirë sesa të shoqërosh popuj të cilët të sigurojnë derisa ta arrish frikën."**

Ky takim i ynë është me një ajet madhështor që fut në zemër frikën. Ajeti i cili po qe se i zbriste kodrave, ato do të copëtoheshin, të cilin sa herë që e kanë dëgjuar veshët, ato kanë heshtur, ajet të cilin sa herë që e kanë lexuar sytë kanë qarë, në të cilin sa herë që është thelluar i pakujdesshmi është penduar. Sa herë që ka medituar ai i cili ia ka kthyer shpinën All-llahut (s.v.t.) është kthyer tek All-llahu i tij dhe është penduar. Ajet në të cilin tregon për një udhëtim... për çfarë udhëtimi..., Ah mjer për atë udhëtim... **"Secili njeri do ta shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen Ditën e Kijametit, e kush i shmanget zjarrit e futet në Xhennet, ai ka arritur shpëtimin, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos një përjetim mashtrues."** (Ali Imran: 85). Për këtë udhëtim të madh thotë i Dërguar (s.a.v.s.): **"Sikur të dinin atë që di unë, do të kishit qeshur pak dhe do të qanit shumë."**

Betohem në Atë, që nuk ka Zot të adhuroar pos Tij, sikur të dinim realitetin e kësaj jete dhe vështirësitë e saj, varrin dhe errësirën, Ditën e Gjykimit dhe tmerret e saj... pastaj të mendonim Xhennetin dhe begatitë e tij...do të kishte ndryshuar gjendja jonë. Por ne kemi harruar apo shtirëmi se kemi harruar këtë udhëtim... Jemi dhënë pas kësaj bote e cila tek All-llahu (s.v.t.) nuk peshon sa fleta e mushkonjës. Përkujto gjendjen tënde kur do të ankohesh prej agonisë së vdekjes në të cilën është ankuar krijesa më e dashur tek All-llahu (s.v.t.), Muhammedi s.a.v.s, i cili thoshte para vdekjes: **"La ilahe il-la ll-llah, me të vërtetë vdekja e ka agoninë e saj."** Paramendo veten tënde o ti i mjerë, se ka zbritur vdekja në fushën tënde... Meleku i vdekjes të qëndron mbi kokë... E gjoksi yt kur të bënë gargara... Gjuha jote të është trashur... Të janë dorëzuar gjymtyrët... Sytë të shtangen ... të mbyllet dera e pendimit për ty... Të djersitet balli...

Atyre u shtohet të qajturit, e prej teje vjen rënkimi, je në një vështirësi të madhe, s'ka kurrfarë shpëtimi dhe ikje, ka mbaruar me ty caktimi... **"Përse pra, kur arrin shpirti në fytyrë, E ju në atë moment shikoni E ne jemi më afër tek ai se ju..."**(Përse) **nuk e ktheni atë** (shpirtin të mos dalë), **E nëse** (ai i vdekuri) **është prej të afërmëve** (të Zotit), **Ai ka** (te Zoti) **kënaqësi, furnizim të mirë dhe Xhennet të begatshëm...E në qoftë se është prej gënjeshtarëve të humbur, Mirëseardhja e tyre është prijte me ujë valë. Dhe dëgjie nga zjarri i Xhennetit...Pra ti lartëso Zotin tënd të madhëruar."** (El-Vakia: 83-96)

Një ditë Harun Rashidi kishte përgatitur ushqim dhe e kishte ftuar Ebu Atijen të cilin i tha: **"Na përshkruaj neve atë që kemi prej mirësisë së kësaj bote? Është përgjigjur: Jeto sa të duash i shëndoshë, nën hijen e pallatit të lartë. Rashidi tha: Bukur, pastaj? Nxitojnë kah ti me gjëra që i dëshiron në mëngjes dhe në mbrëmje. Tha: Shumë mirë, pastaj çka? Kur shpirtat bëjnë gargara nën hijen e dridhjes së gjoksit, atëherë do të jeshë i bindur se nuk ishe tjetër vetëm se mashtrim. Filloi të qajë Harun Rashidi, e një njeri nga ata që ishin të pranishëm i tha Ebu Atijes: **"Të ftoi emiri i besimtarëve që ta gëzosh, ndërsa ti e pikëllove"**. Rashidi tha: **"Lëre atë se ai pasi që na ka parë në këtë gjendje na ka tërhequr vërejtjen"**.**

O ti i mashtruar nga kjo botë! O ti që ia ktheve shpinën All-llahut! O ti i pakujdesshëm ndaj urdhrave të Zotit tënd! O ti që je dhënë pas epsheve dhe që të mashtron shpresa e gjatë, a ke menduar në këto çaste nëse mbetesh, në atë që je? A e din se çka do të ndodhë me ty në çastin e vdekjes, me bindsh-